



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 210, datë 30.09.2020

**PËR MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË, FIGURËS
DHE INTEGRITETIT, SI DHE KUSHTEVE TË TJERA LIGJORE TË KANDIDATIT
TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK
2019-2020, ZNJ. ENKELEDA HOXHA**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, 184 dhe 189 pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Për miratimin e relacionit mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore”, nga komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale të kandidatit për t’u emëruar Prokuror, znj. Enkelelda Hoxha, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatit për t’u emëruar Prokuror, znj. Enkelelda Hoxha, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim znj. Enkelelda Hoxha.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKA**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

